

Varësia e Dyfishtë

Nisur nga fakti që detyrat e ushtruara nga personeli në varësi të NjO-së janë detyra të deleguara nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë, rezulton që personeli i NjO-ve ka varësi të dyfishtë. Ata varen nga Drejtori i Njësisë Operative për sa i përket veprimtarisë administrative dhe nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme për sa i përket detyrave teknike që ata ushtrojnë në NjO.

Në të gjitha rastet kur strukturat e NjO-ve janë në kushtet e varësisë së dyfishtë, urdhrat, udhëzimet, programet e punës dhe çdo element tjetër i punës i dhënë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme kanë prioritet mbi ato të drejtuesve të NjO-ve. Programet e punës të hartuara nga NjO-të si dhe objektivat afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë që NjO-ja përcakton për veprimtarinë e saj në të ardhmen duhet të miratohen detyrimisht nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme janë detyruese për Shoqërinë, aksionarët, organet e tjera, si dhe zyrtarët e Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet në mbledhje nga përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak përkatës të pajisur me autorizim specifik dhe nga përfaqësuesi i AKUK-ut, si enti shtetëror i ngarkuar me përfaqësimin e aksionarit MIE.

Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ushtron funksione kontrolli dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës lidhin me Shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit Mbikëqyrës në terma vjetore. Objektivat për performancën të vendosur në kontratën e punës miratohen nga ministria e linjës, janë të matshëm dhe në përputhje me planin e biznesit.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës

- Almiva Llaçi

- Anisa Jakllari
- Adrian Malaj
- Juna Pali
- Ortion Dhami

Administratori

Administratori i Shoqërisë emërohet nga Asambleja e Përgjithshme, për një periudhe kohe 3 (tre) vjeçare, mbi bazë kontratash të rinovueshme vjetore bazuar në vlerësimin pozitiv të performances së punës.